

**Vendim i Asamblese
se ortakut te vetem
te Shoqerise "ALBAPHOTO" shpk**

Sot me date 14/02/2022, ne seline e Shoqerise "ALBAPHOTO" shpk ne adresen: Rruga Kole Idromeno, Nd.89, H.3, Ap.30, Shkoder, ortaku i vetem i shoqerise Z. Alban Xhaferi, mori ne shqyrtim rendin e dites si me poshte:

- Zmadhimin e kapitalit te shoqerise AlbaSport & Entertainment shpk, shoqeri e regjistruar prane QKB-se, ne date 08/07/2020, me NIPT M06908004I, ne te cilen shoqeria ALBAPHOTO shpk zoteron 100% te kapitalit.
- Te tjera.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin nr. 9901 dt. 04.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, Ortaku i vetem, pasi shqyrtoi rendin e dites, me vullnet te lire dhe te plote:

VENDOSI

- Zmadhimin e kapitalit te shoqerise AlbaSport & Entertainment shpk, nga 12,500,000 leke ne 26,000,000 leke me burim zerin financime te kryera gjate vitit 2021, nga ortaku i vetem, shoqeria Albaphoto sh.p.k, dhe emerimin e ekspertit per hartimin e raportit te zmadhimit te kapitalit.
- Ngarkohet Z. Alban Xhaferi, te firmose si perfaqesues i shoqerise ALBAPHOTO shpk, vendimin e ortakeve te shoqerise AlbaSport & Entertainment shpk.
- Depozitimimin e ketij vendimi prane QKB-se, sipas afateve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i vetem

Alban Xhaferi



AlbaSport & Entertainment shpk
NIPT: M06908004I
Adresa: Stadiumi Loro Boriçi, Rruga Djepaxhijej, 4001, Shkoder

**Vendim i Asamblese
te ortakut te vetem
te Shoqerise “AlbaSport & Entertainment” sh.p.k**

Sot me date 14/02/2022, ne seline e Shoqerise “AlbaSport & Entertainment” sh.p.k ne adresen: Stadiumi Loro Boriçi, Rruga Djepaxhijej, 4001, Shkoder, u mbajt mbledhja e asamblese se ortakut te vetem, Shoqeria ALBAPHOTO shpk, e perfaqesuar nga Z.Alban Xhaferi.

Ortaku i vetem mori ne shqyrtim rendin e dites si me poshte:

- Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë
- Emërimi i Ekspertit Kontabël për hartimin e Raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin nr. 9901 dt. 04.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, Ortaku i vetem, pasi shqyrtoi rendin e dites, me vullnet te lire dhe te plote:

VENDOSI

1. Të zmadhojë kapitalin e shoqërisë nga 12,500,000 lekë në 26,000,000 lekë, me burim financimet që shoqëria ka marrë nga ortakut i vetëm, shoqëria Albaphoto shpk gjatë vitit 2021.
2. Të emërojë shoqërinë e auditimit Albanian Audit Partners shpk, e regjistruar prane regjistrin publik te IEKA, me nr. 186, date 18/02/2010, për hartimin e Raportit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.
3. Ngarkohet Administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi dhe për depozitim të tij, pranë QKB-se, sipas afateve ligjore të përcaktuara.

Ortaku i vetem
ALBAPHOTO shpk
Perfaqesuar nga
Z.Alban Xhaferi Sh.p.k.



**Vendim i Asamblese
te ortakut te vetem
te Shoqerise “AlbaSport & Entertainment” sh.p.k**

Sot me date 25/02/2022, ne seline e Shoqerise “AlbaSport & Entertainment” sh.p.k ne adresen: Stadiumi Loro Boriçi, Rruga Djepaxhijej, 4001, Shkoder, u mbajt mbledhja e asamblese se ortakut te vetem, Shoqeria ALBAPHOTO shpk, e perfaqesuar nga Z.Alban Xhaferi.

Ortaku i vetem mori ne shqyrtim rendin e dites si me poshte:

- Miratimi i Raportit për zmadhimin e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë, i hartuar nga shoqëria auditimit Albanian Audit Partners shpk.
- Miratimi i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë me vleren 13,500,000 leke

Duke u mbeshetur ne Ligjin nr. 9901 dt. 04.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, Ortaku i vetem, pasi shqyrtoi rendin e dites, me vullnet te lire dhe te plote:

VENDOSI

1. Të miratojë Raportin per zmadhimin e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë, të hartuar nga shoqëria auditimit Albanian Audit Partners shpk, me datë 24.02.2022.
2. Të miratojë zmadhimin e kapitalit te shoqerise per shumën 13,500,000 leke, me burim financimet që shoqëria ka marrë nga ortakut i vetëm, shoqëria Albaphoto shpk gjatë vitit 2021. **Efektet e veprimeve te shfaqen ne kontabilitetin e shoqerise ne date 31.12.2021.**
3. Pas zmadhimit kapitali i nenshkruar dhe i derdhur i shoqërisë, ndryshimet ne kapitalin e shoqerise paraqiten si vijon:

Ortaku i Vetëm	Perqindja ne kapital	ISHTE			BEHET		
		Nr. kuotave	Vlera kuotes	Vlera e kapitalit	Nr. kuotave	Vlera kuotes	Vlera e kapitalit
Albaphoto shpk	100%	1	12,500,000	12,500,000	1	26,000,000	26,000,000
GJITHSEJ	100%	1	12,500,000	12,500,000	1	26,600,000	26,000,000

4. Depozitimim e ketij vendimi prane QKB-se, sipas afateve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i vetem

ALBAPHOTO shpk

Perfaqesuar nga

Z.Alban Xhaferi

